



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 201302317/12

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2014

**Lënda:** *Rekomandim për marrjen e masave të nevojshme nga Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore për identifikimin dhe administrimin e kallëzimeve të familjeve të ngujuara për shkak të fenomenit të gjakmarrjes.*

**Drejtuar :** **Z. Adriatik LLALLA**  
**Prokuror i Përgjithshëm**

**Tiranë**

***I nderuar Zoti Llalla,***

E drejta e jetës mbrohet nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (neni 21), disa akte ndërkombëtare, si Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut e OKB (1948), Konventa Evropiane për mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut e Këshillit të Evropës (1950), si dhe Kodi Penal (nenet 76, 77, 78, 78/a, 79, 79/a, 79/b, 79/c, 81, 82, 83).

Gjatë viteve të tranzicionit kjo e drejtë është cënuar seriozisht edhe për shkak të gjakmarrjes. Gjakmarrja në Shqipëri tashmë është kthyer në një fenomen shumë shqetësues për shoqërinë tonë dhe ka marrë përmasa të frikshme sepse cënon të drejtën themelore më të rëndësishme të njeriut, atë të jetës.

Për shkak të gjakmarrjes në vendin tonë kanë lindur edhe disa pasoja të tjera negative dhe regresive sikurse mund të përmendim, ***ngujimin e personave pa dallim gjinie e moshe***, duke u mohuar personave të ngjuar një sërë të drejtash kushtetuese themelore, si atë të lëvizjes së lirë, të arsimimit, të punësimit, të përfitimit të kujdesit shëndetësor, të votimit, të lirisë së organizimit, të lirisë së bindjes dhe shfaqjes së saj etj.

Ndërkohë sjellim në vëmendje se shqetësimin e këtij fenomeni, dhe sidomos vitet e fundit pas liberalizimit të vizave për qytetarët e vendit tonë, po e vuajnë edhe disa vende të BE-së për shkak të numrit të madh dhe në rritje të azilkërkuesve shqiptar të cilët pretendojnë se u rrezikohet jeta në Shqipëri për shkak të këtij fenomeni.

Duke e vlerësuar seriozisht këtë shqetësim, gjatë vitit 2012 e në vijim Institucioni i Avokatit të Popullit ka patur në fokusin e veprimtarisë së vet fenomenin e gjakmarrjes dhe pasojat e tij, sidomos në zonën veriore të vendit ku janë marrë disa jetë njerëzore dhe ndërkohë shumë familje janë ngujuar.

Në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile kemi organizuar disa aktivitete në Shkodër e Tiranë me qëllim sensibilizimin e organeve shtetërore, institucioneve fetare, shoqërisë civile dhe mbarë popullatës për t'u ngritur kundër këtij fenomeni mesjetar dhe me pasoja të rënda për jetën dhe të drejtat e liritë themelore të shtetasve.

Gjatë shqyrtimit të këtij fenomeni kemi konstatuar se, një nga shkaqet që ka ndikuar negativisht për ekzistencën e tij është edhe moszbatimi i ligjit nr. 9389, datë 04.05.2005 "Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Koordinues në luftën kundër gjakmarrjes".

Gjithashtu kemi konstatuar se, shkak për moszbatimin e këtij ligji ka qënë mosnxjerrja nga KM i tre akteve nënligjore në bazë e për zbatim të nenit 7 të ligjit nr. 9389, datë 04.05.2005 "Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Koordinues në luftën kundër gjakmarrjes".

Ne vlerësuam se është me shumë rëndësi nxjerrja e tre akteve nënligjore nga Këshilli i Ministrave në bazë e për zbatim të detyrimeve ligjore që burojnë nga neni 7 ligjit të sipërcituar. Për këtë arsye me shkresën nr. K2/SH41-9 prot., datë 28.08.2012 i kemi rekomanduar Këshillit të Ministrave "*Marrjen e masave të menjëhershme në zbatim të nenit 7 të ligjit nr. 9389, datë 04.05.2005 "Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Koordinues në luftën kundër gjakmarrjes" për përgatitjen dhe nxjerrjen nga Këshilli i Ministrave të akteve nënligjore të parashikuara në nenet 4, 5 dhe 6 të këtij ligji*". Rekomandimi ynë është mirëpritur dhe në zbatim të tij është nxjerrë Urdhri i Kryeministrit Nr.136, datë 14.11.2012 "Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për hartimin e akteve nënligjore në zbatim të nenit 7 të ligjit nr. 9389, datë 04.05.2005 "Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Koordinues në luftën kundër gjakmarrjes", cili kryesohet nga Zëvendësministri i Brendshëm.

Ditët e fundit nga media jemi njohur me Urdhrin nr. 29/1, datë 29.01.2014 të Drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër "Për identifikimin dhe administrimin e kallëzimeve të familjeve të ngjuara". Sipas medias, ky urdhër detyron organet vendore të Policisë së Shtetit dhe drejtuesit e organeve të pushtetit vendor që të evidentojnë të gjitha familjet dhe personat që ndodhen të ngjuar për shkak të gjakmarrjes. Gjithashtu urdhërohen oficerët e policisë gjyqësore që të marrin kallëzime nga personat të cilët janë kanosur për t'u ngjuar.

Ne e vlerësojmë këtë veprim ligjor dhe reagim pozitiv të Drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe kemi bindjen se ai do të ndikoj dhe influencoj për parandalimin e fenomenit të gjakmarrjes në rrethin e Shkodrës dhe për daljen e të ngjuarve. Ndërkohë gjykojmë se, ky veprim pozitiv duhet të shtrihet edhe në organet e tjera të prokurorisë dhe konkretisht

në ato rrethe të cilat janë prekur nga fenomeni i ngujimit për shkak të gjakmarrjes.

Për të bërë të mundur kryerjen e misionit tonë kushtetues e ligjor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve, të cilat janë cënuar rëndë nga fenomeni i gjakmarrjes dhe pasojat e tij, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike” dhe në bazë të nenit 21/b të Ligjit Nr. 8454 dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”,

### **REKOMANDOJMË :**

Marrjen e masave të nevojshme që, nisma pozitive e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër “Për identifikimin dhe administrimin e kallëzimeve të familjeve të ngjuara”, të shtrihet edhe në organet e tjera të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor në ato rrethe të vendit të cilat janë prekur nga fenomeni i ngujimit për shkak të gjakmarrjes.

Për qëndrimin dhe masat që do merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditore, sipas nenit 22 të Ligjit Nr. 8454 dt.04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin Tuaj,*

**AVOKATI I POPULLIT**

**Igli TOTOZANI**